



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 47/2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Ferizaj, paraqitur kundër Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dega në Ferizaj, për shkak të fillimit të fushatës para kohës së caktuar për fushatë zgjedhore, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 20.04.2012, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET poshtë ankesa si e palejuar.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më 19.04.2012, nga subjekti politik LVV dega në Ferizaj, më të cilën pretendohet se subjekti politik PDK përkatësisht lideri i këtij subjekti Hashim Thaçi, ka qëndruar në Komunën e Lipjanit me datën 17.04.2012, duke bërë thirrje qytetarëve të kësaj komune që të ndikojnë te qytetarët e Ferizajt dhe të të afërmit që i kanë në këtë komunë. Sipas parashtruesit të ankesës subjekti politik PDK, ka bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes për Subjekt politik dhe Kandidatët e tyre dhe Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP). Më tej parashtruesi i ankesës potencon se neni 64 paragrafi 1 i LZP-së e përcakton përgjegjëse KQZ-në për zbatimin e këtij ligji, po ashtu ka theksuar në ankesë se KQZ-ja, ka nxjerrë një vendim që në pasuesin 7 të këtij vendimi përcaktohet se fushata zgjedhore në Ferizaj fillon më 23 prill 2012 dhe do të zgjasë 5 ditë që do të thotë një ditë para ditës së zgjedhjeve.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë foton e kryeministrit Hashim Thaqi, para qytetarëve si dhe fjalimin e tij. Me propozim që të shqiptohen masa e parapara ligjore ndaj subjektit politik në fjalë.

Neni 33 dhe 44 i LZP-së, Rregulla Zgjedhore nr. 11/2009, *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët* dhe Rregulla Zgjedhore Nr. 13/2009 *Fushata e zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike*, përcaktojnë aktivitetet e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, siç del nga të gjitha dispozitat ligjore dhe Rregullat Zgjedhore të lartcekura, ndalojnë veprimet e subjekteve politike, mbështetësit e tyre ose kandidatët e tyre gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

PZAP-i nga shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e palejuar.

Meqenëse pretendimet nga parashtruesi i ankesës nuk janë bërë gjatë periudhës së fushatës zgjedhore sepse siç del ngase dispozitat e lart cekura ligjore, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se është bërë shkelje e kodit të mirësjelljes ngase me LZP e as me Rregulla Zgjedhore nuk është paraparë asnjë dispozitë ligjore që e ndalon sanksionon fillimin e fushatës zgjedhore para datës së caktuar për fushatë zgjedhore, andaj në kuptim të nenit 115.1 të LZP, PZAP-i vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 47/2012 më datën 20.04.2012.

